



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.1043/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me apelet e Shpresa Tafa, Vahit Halimi dhe Abdullah Kelmendi, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 13.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHEN si të pa rregullta apelet e apeluesve: Shpresa Tafa, Vahit Halimi dhe Abdullah Kelmendi, me numër: ZL.Anr.1043/2017, ZL.Anr.1049/2017, dhe ZL.Anr.1052/2017, të datës 13.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017,

A r s y e t i m

Me datën 13.11.2017, PZAP-i ka pranuar me postë apelet 3 apele, apelin e parashtruar nga Shpresa Tafa, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Shtime, nga radhët e subjektit politik PDK, apelin e Vahit Halimi kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Prizren, nga radhët e subjektit politik PDK dhe apelin e parashtruar nga Abdullah Kelmendi, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Vushtri, nga radhët e subjektit politik AKR. Apeluesit në apelet e tyre theksojnë se ka pasur mungesë të votave pas shpalljes së rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017.

Paneli, në bazë të nenit 13.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar apelet e lartcekura dhe i trajton si një apel i evidentuar me ZL.Anr.1043/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve dhe për tri apele që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato apele të trajtohen me një vendim i vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të rregullsisë së apelit, gjeti se:

Apelet janë të pa rregullta

PZAP-i, nga shkresat e lëndës vlerësoj se apelet e parashtruara nga ana e apeluesve të lartcekur, janë të parregullta, sepse nuk janë të nënshtruara nga parashtruesit e apeleve dhe si të tilla apelet nuk i plotësojnë kriteret e Rregullës Nr.02/2015 të nenit 10.6, ku

përcaktohet se: Apelet duhet të dorëzohen me shkrim dhe duhet të jenë të nënshkruara nga parashtruesi i apelit apo në emër të tij nga i autorizuari.

Prandaj PZAP-i, nuk u lëshua fare në vlerësimin e meritave të apeleve, ngase apelet nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara nga dispozitat ligjore e lartëtheksuara.

Nga arsyet e sipërshënuar e në mbështetje të nenit 10.6 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL. Anr.1043/2017 më datën 13.11.2017



Kryesuese e Panelit
Gyltene Sytejmani

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.